

Ekskluzive

Ekskluzive | Sherri familjar zbulon arsenal armësh në Prishtinë – katër persona përfundojnë në pranga



Sinjali.com

19 Korrik 2026 09:41



Një konflikt familjar në Prishtinë ka marrë përmasa të rënda, duke përfunduar me bastisje policore, sekuestrim armësh dhe arrestimin e katër anëtarëve të së njëjtës familje, raporton Sinjali.

Sinjali mëson ekskluzivisht se të arrestuarit janë **Ahmed Shabani**, 26 vjeçar, **Ismail Shabani**, 22 vjeçar, **Jeset Shabani**, 64 vjeçar dhe **Abdusamet Shabani**, 30 vjeçar, ndërsa viktimë e rastit është E. H., 34 vjeçar.

Sipas burimeve të Sinjalit, ngjarja ka ndodhur mbrëmjen e 18 korrikut, rreth orës 19:00, në rrugën “Apollonia” në Prishtinë, ku Policia u njoftua për një mosmarrëveshje familjare që kishte eskaluar në dhunë.

Nga deklaratat e viktimës dhe dëshmitarëve rezulton se konflikti kishte kaluar nga përplasja verbale në sulm fizik dhe kanosje, ndërsa është raportuar se disa nga të dyshuarit posedonin armë zjarri në shtëpi.

Pas bastisjes në shtëpinë e Ahmed Shabanit, Policia ka sekuestruar një pushkë automatike të prodhimit kinez, një karikator, 59 fishekë të kalibrit 7.62 mm dhe një jelek antiplumb taktik.

Ndërkaq, në shtëpinë e Ismail Shabanit është gjetur edhe një pushkë ajrore e kalibrit 4.5 mm, e cila gjithashtu është sekuestruar.

Viktima ka marrë trajtim mjekësor, ndërsa të gjithë personat e përfshirë janë shoqëruar në Stacionin Policor “Jugu”, ku janë intervistuar në prani të avokatëve mbrojtës.

Në vendngjarje ka dalë edhe Prokurori kujdestar për të mbikëqyrur personalisht zhvillimin e hetimeve.

Me vendim të Prokurorit të Shtetit, katër të dyshuarit janë dërguar në ndalim policor për 48 orë, ndërsa ndaj tyre janë iniciuar procedura për veprat penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, “Kanosja”, “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë” dhe “Sulmi”.

Hetimet për rastin janë në vazhdim.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

kater persona arresohen

Sherr Familjar

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera